



BULETIN JAVOR

27-31 MAJ 2024



PËRMBAJTJA

- Trajnim ndërgjegjësues mbi higjienën kibernetike
- Trajnimi i AKSK për rritjen e kapaciteteve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit me AKSHI
- Pjesëmarrës në Konferencën e 4-të Ndërkombëtare mbi Inovacionet në Teknologji, Biznes dhe Transformim (ICITTBT)
- AKSK Trajnon Studentët e Universitetit "Aleksandër Xhuvani" në Elbasan për Sigurinë Kibernetike

Trajnim ndërgjegjësues mbi higjienën kibernetike



Në vazhdim të fushatës për ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi higjienën kibernetike dhe mbrojtjen nga kërcënimet kibernetike, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), në bashkëpunim me CRDF Global dhe me mbështetjen e Departamentit Amerikan të Shtetit, organizoi me sukses trajnimin "Higjiena kibernetike dhe praktikat më të mira të sigurisë".

Ky aktivitet i zhvilluar onsite dhe online tërhoqi mbi 2000 pjesëmarrës online në dy ditët e trajnimit, Tiranë dhe Vlorë. Në hapjen e trajnimit morën pjesë Drejtori i Përgjithshëm i AKSK, Z. Igli Tafa, dhe përfaqësues nga Ambasada Amerikane në Tiranë. Trajnimi theksoi rëndësinë e sigurisë kibernetike në sektorin publik dhe përfshiu nëpunës nga institucione të ndryshme të administratës publike.

Trajnimi i AKSK për rritjen e kapaciteteve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit me AKSHI

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) në kuadër të rritjes së kapaciteteve të ekspertëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit zhvilloi trajnimin në datat 29-30 Maj 2024 me pjesëmarrje të specialistëve nga AKSHI.

Nëpërmjet këtij trajnimi u synua që specialistët IT/CT të njiheshin dhe ndërgjegjësoheshin në fushën e sigurisë kibernetike, të aftësoheshin për të dhënë përgjigje ndaj incidenteve kibernetike dhe të përgatiteshin për identifikimin e kërcënimeve.

Tematikat që u zhvilluan në këto dy ditë trajnimi ishin të ndara në tre faza:

- Prezantim/ ndërgjegjësim për masat e sigurisë kibernetike dhe menaxhimi i rrezikut.
- Table Top Exercise (TTX)
- Cyber Drill (CD)- Simulime reale të incidenteve të sigurisë kibernetike.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aks.gov.al



@autoriteti_kombetar_sk



+355 422 21 039

Pjesëmarrës në Konferencën e 4-t Ndërkombëtare mbi Inovacionet në Teknologji, Biznes dhe Transformim (ICITTBT)



Më datë 30 Maj, u zhvillua Konferenca e 4-të Ndërkombëtare mbi Inovacionet në Teknologji, Biznes dhe Transformim (ICITTBT), organizuar nga Canadian Institute of Technology. Në këtë aktivitet morën pjesë akademikë, liderë të industrisë dhe profesionistë të fushës.

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike u përfaqësua nga znj. Esmeralda Kazia, Drejtor i Monitorimit dhe Reagimit të Incidenteve Kibernetike, Qendrës Operacionale SOC C-SIRT. Fjalimi i saj nënvizoi rëndësinë e sigurisë kibernetike në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur dhe dinamike. Znj. Kazia theksoi përpjekjet e Autoritetit për të monitoruar, identifikuar dhe zbutur kërcënimet, si dhe për të forcuar infrastrukturën digjitale.

Gjithashtu, vendosi theksin në rëndësinë e kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit ndërdisiplinor, duke inkurajuar partneritetet strategjike për avancimin e sigurisë kibernetike. Konferenca shërbeu si një platformë unike për shkëmbimin e njohurive dhe nxitjen e bashkëpunimeve të reja.

AKSK Trajnon Studentët e Universitetit "Aleksandër Xhuvani" në Elbasan për Sigurinë Kibernetike

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) zhvilloi një trajnim me studentët e Universitetit Aleksandër Xhuvani në Elbasan, me fokus fushën e Sigurisë Kibernetike. Nëpërmjet këtij trajnimi synohej ngritja e kapaciteteve të studentëve dhe aftësim i tyre në fushën e sigurisë kibernetike.

Ekspertët e Autoritetit e ndanë trajnimin në dy faza:

- Pjesa teorike ku shpjeguan hapat që duhet të ndërmerren gjatë menaxhimit të një incidenti kibernetik.
- Pjesa praktike (Cyber Drill Exercises) ku u krye një simulim i rasteve të një incidenti kibernetik.

